



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të dëgjimit publik të bashkësive lokale (BL-ve), lagjeve dhe fshatrave të komunës së Prishtinës, mbajtur më 29.08.2019, duke filluar në orën 18:00.

Morën pjesë: Osman Bllaca, përfaqësues nga ekzekutivi, Gëzim Mehmeti , drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Fatime Hajdari drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Shkumbin Gashi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë.

Të pranishëm ishin edhe: Hetem Kupin, përfaqësues i BL-së Bardhosh, Bajram Borovci, përfaqësues nga fshati Shkabaj, Feim Osmani kryetar i BL-së Besi, Dibran Rexha, përfaqësues nga fshati Rimanishtë, Abdurrahman Dragusha, kryetar i BL-së Prugovc, Vigan Hoxha, banor i lagjes “Bregu i Diellit”, Feti Deliu, përfaqësues i BL-së së lagjes “Veterniku” dhe Haki Aliu, kryetar i BL-së XII/1.

Diskutimin e hapi dhe e kryesoi **Osman Bllaca**, përfaqësuesi nga ekzekutivi. **Osman Bllaca** fillimisht i përshëndeti të pranishmit, duke cekur se ky është diskutimi buxhetor, që do të merret parasysh në hartimin e buxhetit për vitin 2020 dhe Kornizën afatmesme buxhetore për tri vitet e ardhshme, 2020 – 2022, ku do t'i trajtojmë kërkesa e paraqitura nga përfaqësuesit e BL-ve, lagjeve dhe fshatrave, dhe të shohim se cilat janë me prioritet, me qëllim që t'i fusim në buxhetin e vitit 2020.

Hetem Kupina, përfaqësues i BL-së Bardhosh, tha se në kuadër të kësaj bashkësie lokale bëjnë pjesë 7 vendbanime: Trudë, Milevc, Bërnice e Epërme, Sinidoll, Bërnice e Poshme, Bardhosh dhe Bardhoshi i Poshtëm. Bazuar në faktin se të gjitha këto vendbanime kanë nevoja të mëdha për investime, sidomos në infrastrukturën rrugore, duke filluar nga “Albi Market” deri në Bardhosh, pra kërkohet renovimi i rrugës dhe zgjerimi i saj. Për lagjen “Braina”, ku ka më se 80 shtëpi, kërkohet rregullimin e rrugës, me gjatësi rreth 1 km.

Nga Drejtoria e Arsimit kërkohet hapjen e një çerdheje në Bardhosh, meqë lokacioni është i gatshëm.

Gjithashtu kërkojmë që të përmirësohen kushtet në shërbimin shëndetësor në këtë lokacion, që ky objekt shëndetësor të ngrihet edhe për një kat, me qëllim të plotësimit të nevojave të qytetarëve dhe, brenda mundësive, Ambulancën shëndetësore me shndërrua në QMF.

Bajram Borovci, banor i fshatit Shkabaj, paraqiti kërkesat e banorëve të këtij fshati, kërkesa këto që pritet të realizohen tash e 6 vjet, pra asnjëra nga to deri më sot nuk janë realizuar. Ky fshat ka nevojë për rregullimin e rrugës, rrugicave, e në veçanti kërkojmë rregullimin dhe ndriçimin e rrugë "Vjena", me gjatësi prej 210 m, sepse këtu kemi një biznes ku do të mund të punësoheshin 10 punëtorë.

Të ndërtohet dhe ndriçohet rruga dhe kanalizimi te familja Fazliu, diku rreth 100 m gjatësi. Ai njëherësh ngriti shqetësimin rreth gjendjes së kuadrit të shkollës të këtij lokaliteti, sidomos në lëndët gjuhë shqipe, gjuhë angleze, kimi, fizikë dhe edukatë fizike, duke thënë se në këtë shkollë janë sjellë arsimtarë nga shkollat e tjera.

Objekti i shkollës nuk i plotëson as kushtet themelore të nxënësve. Kemi kërkuar që të bëhet mbindërtim ose aneks dhe të plotësohen nevojat e qytetarëve të këtij fshati, por më parë do të duhej ndërruar kuadri. Mbi 50 nxënës i kemi dërguar në Prishtinë në shkollë, për shkak të kushteve të vështira. Kësaj shkolle i mungon edhe fusha sportive. Edhe siguria e nxënësve në komunikacion vihet në rrezik nga lëvizja e automjetet, ku dhe kemi kërkuar që në rrugë të vendosen disa pengesa. Kemi kërkuar që 1.5 - 2 km autobusi të vazhdojë të qarkullojë, në mënyrë që t'u krijojë qasje edhe 60 shtëpive të tjera. Kemi kërkuar një objekt të kulturës. Nuk kemi as bibliotekë, as çerdhe, kemi problem me ambulancën për orarin e punës, sidomos për mosfunksionimin gjatë ditëve të shtuna dhe të diela.

Problemi tjetër me të cilin ballafaqohemi është edhe rreziku nga qentë endacakë.

Osman Bilaca, sa u përket kërkesave, e sidomos ato që u cekën për mësimdhënësit, dhe njëri prej rasteve të cekura na është prezantuar neve nga drejtori i shkollës, si kryetar i Komisionit disiplinor, mund të them se e trajtuam rastin e mësimdhënësit të lëndës fizikë - kimi, të cilën e kemi orientuar në bazë të procedurave disiplinore si të veprojnë, por për shkak të disa rrethanave familjare të mësimdhënësit, drejtori ka hezituar që këtë çështje ta iniciojë për në Komisionin disiplinor. Është e vërtet se duke pasur parasysh këto rrethana, ka nxënës që janë transferuar, apo dëshirojnë të transferohen për shkak të një ambienti të tillë, mirëpo duhet shikuar mundësinë e një zgjidhjeje.

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se së shpejti do të intervenohet në lagjen "Shkabaj", ku janë paraparë disa rrugë që janë shumë të nevojshme për të intervenuar.

Medina Braha, drejtoreshë, tha se ne kemi vazhdimisht kërkesa për vendosjen e pengesave në rrugë, prandaj nëse i shqyrtojmë kërkesat për pengesat në rrugë, duhet të shkohet në formën përmes BL-ve me ata banorë dhe me nënshkrime të noterizuara, pastaj ne i shqyrtojmë si të tilla. Sa i përket zgjatjes së vijës së autobusit edhe për disa kilometra, do të dalim të shohim se si është gjendja në terren dhe si janë mundësitë për zgjidhjen e këtij problemi.

Feim Osmani, kryetar i BL-së Besi, tha se në kuadër të kësaj bashkësie lokale hyjnë edhe fshatrat Rimanishtë, Teneshdoll, Vranidoll dhe Sibovc. Gjatë një viti në këto lokalitete janë investuar vetëm 90 mijë €, dha ajo nga Drejtoria e Investimeve Kapitale, që i ka përfshirë disa rrugica në fshatin Teneshdoll dhe asgjë ma shumë.

Shumë projekte, si ato të disa rrugicave në Besi, të cilat janë projektuar dhe nuk kanë kaluar asnjë herë, nuk janë buxhetuar. Po ashtu, edhe një sallë e sportit në shkollën fillore te mesme

të ulët "Nazmi Mustafa", rregullimi i rrugës kryesore Besi –Rimanishtë, e cila është në gjendje të keqe. Kemi kërkuar edhe rregullimin e një mbikalimi, apo nënkalimi në magjistralen Prishtinë – Podujevë, si dhe kemi ngritur zërin kundër degradimit të natyrës, gjegjësisht prerjes ilegale të pyjeve.

Është më se i nevojshëm ndërtimi i një pjesë të kanalizimit atmosferik në Vranidoll, mungon ndriçimi i rrugës në fshatin Tenezhdoll, si dhe rregullimi i varrezave. Gjithashtu shkolla në Vranidoll është në gjendje jashtëzakonisht të keqe, andaj do të ishte mirë që Komuna ta bënte rregullimin e saj.

Medina Braha, drejtoreshë, tha se sa i përket çështjes së ndriçimit, kontrata për shtrirjen e rrjetit të ndriçimit është në procedura të tenderimit.

Sa i përket varrezave, jemi duke pritur nënshkrimin e një kontrate, por është për varrezat e Prishtinës, në ndërkohë do të shohim si do të shkojë puna me ato tjerat.

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se për ndërtimin e mbikalimit kompetente është ministria përkatëse, ndërsa sa i përket rregullimit të kanalizimit dhe murit mbrojtës, së shpejti do të përfundojnë procedurat për vlerësimin e tenderit.

Dibran Rexha, përfaqësues nga fshati Rimanishtë, kërkoi që projektet për rrjetin e kanalizimit dhe ndërtimit të rrugëve, ndriçimit të tyre dhe rregullimin e varrezave, të kryhen sa më shpejtë. Mendoj se këto kërkesa janë të arsyeshme dhe të drejta.

Gëzim Mehmeti, drejtor, tha se në bazë të hulumtimeve që i kemi bërë, gjendja shumë më keq është në qytet sesa në pjesët urbane në komunën e Prishtinës, për këtë arsye edhe fokusi për vitin 2019 ka qenë më shumë në lagjet e Prishtinës, por besoj se të gjitha kërkesat e BL-ve do të merren parasysh.

Abdurrahman Dragusha, kryetar i BL-së Prugovc, tha se në kuadër të kësaj BL-je përfshihen 5 lagje të Prugovcit dhe fshatin Lebanë, ku edhe ne i kemi kërkesat për shërbimet publike, për ndriçimin e disa rrugëve, që këto projekte të përfshihen në buxhetin e vitit 2020. Po ashtu kërkoj që në fshatrat Lebanë dhe Prugovc të bëhet rrethoja e varrezave.

Kërkojmë që të jetë edhe një linjë autobusi e Trafikut Urban në relacionin Prishtinë – Teneshdoll, si ka qenë më parë. Shqetësim për banorët e këtij lokaliteti janë qentë endacakë, që paraqesin rrezik të madh për banorët. Kërkojmë që në lagjen e pestë dhe në lagjen e dytë të kësaj BL-je, të rregullohet rrejtja e kanalizimit, të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike. Shqetësim i madh është edhe uzurpimi i pronave të varrezave, ku aty janë bërë ndërtime të objekteve, kryesisht në fshatrat Prugovc dhe Lebanë.

Është më se i nevojshëm edhe ndërtimi i terreneve sportive, ku aty afër është një hapësirë publike prej 5 hektarësh.

Medina Braha theksoi se sa i përket rrezikut nga qentë endacakë, deri vonë kemi pasur një kontratë, sipas së cilës janë marrë qentë endacakë, janë vaksinuar kundër tërbimit dhe helmimit dhe janë lëshuar. Tani ajo kontratë veç ka përfunduar. Për këtë vit është paraparë të ndërtohet një qendër për strehimin e tyre, ku qentë do të mbesin aty dhe nuk do të lirohen.

Për linjë të autobusit, kemi filluar përpilimin e planit të ri të linjave në qytet dhe për zonat rurale. Është një model biznesi për futjen e operatorëve privatë në sistem, pasi që me ligj gjysma e linjave duhet me qenë publike në kuadër të ndërmarrjes "Trafikut Urban", e gjysma tjetër e ushtruar nga operatorët privatë, por këto synime kërkojnë kohë për t'u realizuar.

Gëzim Mehmeti tha se sa i përket projekteve në infrastrukturë për fshatin Prugovc, në vitin 2017 është nënshkruar kontrata, me vlerë prej 500 mijë €, mjete të cilat janë shpenzuar për realizimin e projekteve.

Sa i përket kanalizimeve në territorin e Prishtinës, janë ndarë diku afër 100 milionë euro, e aty do të përfshihen kanalizimet e Obiliqit, Fushë-Kosovës, Graçanicës dhe territorin e Prishtinës, e që nënkupton se do të ndërtohet impianti kryesor për pastrimin e ujërave në Bresje, komuna e Fushës-Kosovës, ku do të ketë edhe impiante të vogla. Këtu përfshihen edhe kanalizimet nëpër të gjitha fshatrat.

Vigan Hoxha banor i lagjes “Bregu i Diellit”, u shpreh se jam tejet i brengosur për gjendjen e këndit të lodrave dhe parkun në përgjithësi. Si shfrytëzues i këtyre hapësirave, shoh se situata është duke u degraduar. Do të ishte mirë të rregullohen ato që janë, e pastaj me menduar me hapur edhe kënde të tjera të fëmijëve dhe me i mirëmbajtur ato.

Fatime Hajdari, drejtoreshë, tha se Komuna ka bërë mirëmbajtjen e këndeve të lojërave për fëmijë dhe disa parqeve përmes kompanive private, të cilat kanë ardhur përmes prokurimit, por ky model nuk ka funksionuar si duhet dhe jemi obligua si Komunë me gjetur një zgjidhje për këtë shqetësim.

Mirëmbajtja e këtyre parqeve dhe këndeve të lojërave për fëmijë, i është besuar kompanisë Ndërmarrjes Publike Banesore, ku shumica prej tyre mund të rinovohen, por një pjesë e tyre duhet me u larguar tërësisht, në mënyrë që me sanuar situatën aktuale që është.

Feti Deliu, përfaqësues i lagjes “Veterniku”, tha se në kuadër të territorit të kësaj BL-je nuk ekziston asnjë shkollë, nuk ka as shkollë private, as publike, asnjë çerdhe të fëmijëve, asnjë kopsht të fëmijëve, as ambulancë familjare shëndetësore.

Në korrik të vitit 2018, janë përfunduar të gjitha procedurat për shpalljen e tenderit për ndërtimin e një ambulance, por sipas të dhënave që kemi marrë nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, thuhet se shoqata e cila ka me e ndërtuar është duke përgatitur projektin. Po ashtu, edhe për shkollë kemi bërë të njëjtën kërkesë, por deri më sot nuk u morën parasysh, si dhe shumë kërkesa, nga të cilat asnjëra nuk është realizuar.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga parafolësi, sqarime të nevojshme dha **Osman Bllaca. Haki Aliu**, kryetar i BL-së XII /1, në emër të banorëve të fshatrave Glllogovicë, Dabishevc, Keçekollë dhe Prapashticë, tha se në këto lokalitete nuk ka rrugë të rregulluara. Kemi këkuar që linja e autobusit të vazhdojë nga Keçekolla deri në Glllogovicë.

Gëzim Mehmeti theksoi se në këto lokalitete janë bërë disa investime, sidomos në Prapashticë, pastaj në lagja “Balaj”, ku janë ndarë më se 100 mijë €. Sivjet kanë qenë dy investime për Glllogovicë, bazuar në kërkesat e BL-së. Po ashtu, kemi bërë asfaltimin e rrugë në lagjen “Hajdaraj”, pastaj rruga Çelaj –Halilaj- Keçekollë, rruga nga Kopranët deri te lagjja e Sijarinëve, deri në Dabishevc.

Bajram Hasani, nga BL- Keçekollë, përfaqësues nga fshati Zllash, tha se në këtë lokalitet kemi disa rrugica, me gjatësi prej 1 km, që janë të pakalueshme dhe deri më sot asnjëra nga ato nuk janë rregulluar.

Gëzim Mehmeti tha se janë disa rrugë që kanë rëndësi të jashtëzakonshme për qarkullim në pjesën e Gollakut, siç është rruga Stallovë – Zllash e deri në Viti, dhe besoj se vitin e ardhshëm është në planifikim për asfaltim. Pastaj do të asfaltohet rruga Zllash – Prapashticë, duke kaluar nga Sekiraqët.

Feim Osmani, përfaqësues nga BL-ja Besi, tha se subvencionet për bujqësi që i ndan Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë, a ka me vazhdua përmes një organizate tjetër, siç kanë qenë thirrjet përmes mbështetjes për me i përkrahur projektet, siç kanë qenë dy vitet e fundit, sipas ADA austriake, apo do t'i përkrahë vetë projektet, pra si ka me vazhdua në vitin 2020, sepse ka pasur metoda tjetër këto dy vitet e fundit edhe bujqit janë të painformuar?

Shkumbin Gashi, drejtor, tha se sa i përket subvencioneve dhe granteve, këto dallojnë, sepse ADA austriake ka shpërndarë grante, ndërsa subvencionet, pagesat direkte i kemi pasur ne si Drejtori e Bujqësisë.

Hetem Kupina kërkoi nga të gjitha drejtoritë e Komunës që të dëgjohet përmbajtja e zërit të përfaqësuesve të BL-ve.

Diskutimi publik përfundoi në orën 19:35.